

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Raporte Financiare 3-Mujore Për periudhën e mbyllur më: 30/06/2024

Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 [i ndryshuar] të Bankës së Shqipërisë

PERMBAJTJA:	Faqe
1. Bazat e përgatitjes dhe Përmbledhje e Politikave Kontabël	1 - 6
2. Tregues të rentabilitetit të bankës	7
3. Pozicioni financiar, Pasqyra e të Ardhurave dhe zërat jashtë bilancit të përmbledhura	8 - 9
4. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	10
5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë	11
6. Klasifikimi i portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike (rretheve)	12 - 13
7. Kreditë që u ka kaluar afati & kreditë me probleme sipas shpërndarjes gjeografike	14
8. Klasifikimi i portofolit të kredive sipas tipit të industrisë dhënë rezidentëve (rretheve)	15 - 16
9. Shpenzimet për provigjone sipas sektorëve	17
10. Fondet për provigjone dhe lëvizjet gjatë periudhës	18
11. Aktivët sipas maturimit përfundimtar	19
12. Pasivet sipas maturimit përfundimtar	20
13. Struktura e kapitalit rregullator; Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit: Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional	21

Tiranë, më 19/07/2024

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a ("Banka") është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme.

Bazuar në nenin nr.2 të Statutit të të Bankës, objektivi i Bankës është të veproje, për llogari të vet apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Raiffeisen Bank sh.a. është krijuar dhe themeluar si dhe operon vetëm në Shqipëri.

Raiffeisen Bank sh.a. është shoqëri e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri me 100 % të kapitalit.

Më 30 Qershor 2024, Banka operon me një rrjet bankar prej 74 pika shërbimi në të gjithë Shqipërinë (31 dhjetor 2023: 74 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 3 Distrikte. Numri i punonjësve të Bankës më 30 Qershor 2024 është 1,327 punonjës (31 dhjetor 2023: 1,300).

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptare ("Lek"), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lek, cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

(ii) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 30 Qershor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 (Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	30 Qershor 2024	31 Dhjetor 2023
Dollari Amerikan (USD)	93.70	93.94
Monedha Europiane (EUR)	100.31	103.88
Paundi Britanik (GBP)	118.47	119.47

3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraaja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë ("Banka Qëndrore").

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.3 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për rënien në vlerë.

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e tregut

Vlera e tregut për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara përcaktohet duke iu referuar çmimeve të ofruara (bid) të kuotuar gjatë mbylljes së bursës në datën e bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së tregut përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër, i cili është i përafërt në natyrë. Vlera e tregut, gjithashtu, mund të bazohet në rrjedhjen e pritshme të parasë, ose mbi bazën neto të aktivitetit për letrën me vlerë në fjalë.

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje të anasjellta të riblerjes) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlogaritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha këto marrëveshje bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.4 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Banka i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Banka dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjionet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjioneve të përgjithshme të njohura në bilancin e Bankës, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer të detyrimit.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja" miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjioneve:

Kategoria e huasë	Provigjioni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjionin për huatë e këqija, shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën individuale të të ardhurave në zërin "Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative".

Banka nuk përlogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbetur e huave, për të cilat nuk përlogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjionin për humbjet e pritshme. Provigjioni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

Politikat e fshirjes së kredive

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

3.5 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara shprehen me koston historike të blerjes plus rivlerësimet (në rastin e ndërtesave) minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Ndërtesat shprehen me vlerat e rivlerësuara, të cilat janë vlerat reale në bazë të përdorimit aktual në datën e rivlerësimit, minus ndonjë zhvlerësim pasues të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë vijuese të akumuluar. Rezultati i rivlerësimit është paraqitur në rezervat e rivlerësimit.

Zhvlerësimi dhe amortizimi paraqiten si pakësim i kostos së mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim dhe jetëgjatësitë të vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	30 Qershor 2024 (në vite)	31 Dhjetor 2023 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Automjete	7	7
• Kompjuterat dhe pajisje informatike	4 deri në 7	4 deri në 7
• Software dhe Licensa	8	8
• Makineri dhe sisteme	7	7
• Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7	5 deri në 7
• Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10	1 deri në 10

Toka dhe punimet në proçes nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën individuale të të ardhurave në periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.6 Pronat e rimarra në zotërim

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, dhe njihen në pasqyrat financiare individuale si "Aktive të tjera". Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

3.7 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.8 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.9 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

3.10 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin më 30 Qershor 2024 llogaritet 15% (31 Dhjetor 2023: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.12 Pjesëmarrje në filial

Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Leasing Sh.a. Raiffeisen Leasing Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar sipas vendimit të Gjykatës së Tiranës Nr.35733 të datës 15 Maj 2006 dhe ushtron aktivitetin e qiradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm "Mbi Qiradhënien Financiare".

Banka ka blerë 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Sh.a. Blerja është aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr 30, datë 26 Mars 2009, regjistruar në Qendra Kombëtare e Regjistrimit më 23 Prill 2009.

3.13 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qenë se për instrumentat financiarë të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiarë të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Bankës kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrjnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose rriçmohen brenda vitit.

3.14 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

3.15 Krahasueshmëria

Politikat kontabël të adoptuara nga Banka janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

Tregues të rentabilitetit të bankës *

Tregues të rentabilitetit të bankës *	30/6/2024	31/3/2024	31/12/2023	30/9/2023	30/6/2023	31/3/2023	31/12/2022
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100];	2.76 %	2.59 %	2.57 %	2.40 %	1.58 %	1.97 %	1.5 %
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.0 %	0.1 %
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	25.6 %	28.6 %	24.7 %	25.7 %	26.5 %	29.4 %	29.3 %
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	212.3 %	199 %	215 %	214 %	208 %	192 %	161 %
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100];	23.49 %	22.31 %	21.85 %	20.10 %	13.33 %	17.00 %	13.1 %
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000;	225,724	227,841	235,660	230,301	225,080	225,974	224,603
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	4.3 %	4.2 %	4.1 %	4.0 %	2.6 %	3.8 %	2.9 %
8. Marzhi neto nga interesat: [Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare qe sjellin te ardhura]	5.1 %	5.0 %	4.9 %	4.8 %	3.1 %	4.5 %	3.7 %
9. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare;	4.6 %	4.5 %	4.3 %	4.2 %	2.7 %	3.9 %	3.1 %
10. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;	0.3 %	0.3 %	0.2 %	0.2 %	0.1 %	0.2 %	0.2 %
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	54.4 %	57.0 %	53.1 %	55.0 %	55.1 %	56.4 %	47.1 %
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	1.0 %	1.0 %	1.0 %	1.1 %	0.6 %	0.9 %	1.1 %
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	54.4 %	52.8 %	59.0 %	58.8 %	58.1 %	60.5 %	69.1 %
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	12.6 %	13.1 %	12.3 %	12.8 %	12.9 %	13.3 %	14.6 %
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	0.0%	0.0%	0.1 %	0.2 %	0.0 %	0.1 %	0.3 %

(*) Treguesit janë llogaritur sipas kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë (i ndryshuar)

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilancit

Aktiv në mijë Lekë	30/06 2024	31/12 2023	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	39,964,810	41,876,906	-1,912,097	-4.6%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	24,467,216	28,097,371	-3,630,155	-12.9%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	32,074,443	32,526,513	-452,070	-1.4%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	116,389,036	119,144,359	-2,755,323	-2.3%
Letra me vlerë	78,879,528	76,667,571	2,211,957	2.9%
Investime në filiale	329,205	329,205	-	0.0%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	-	-	-	0%
Tatim fitimi për t'u arketuar	-	-	-	0%
Mjete të patrupëzuara	2,114,233	2,183,419	-69,186	-3.2%
Mjete të trupëzuara	3,211,944	3,324,389	-112,445	-3.4%
Mjete të tjera, neto	2,105,426	2,208,642	-103,216	-4.7%
Totali aktiveve	299,535,840	306,358,374	-6,822,534	-2.2%

Detyrimet dhe kapitali në mijë Lekë	30/06 2024	31/12 2023	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	-	-	-	0.0%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	2,730,055	-	2,730,055	-
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	8,929,113	9,367,294	-438,181	-4.7%
Detyrimet ndaj klientëve	242,255,917	251,822,856	-9,566,938	-3.8%
Detyrimet ndaj qeverisë dhe organizatave publike	335,241	354,045	-18,804	-5.3%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	2,103,305	2,170,713	-67,407	-3.1%
Fonde rezervë për rrezique dhe shpenzime	1,347,005	1,382,077	-35,071	-2.5%
Borxh i varur	2,034,242	2,106,944.95	-72,703	-3.5%
Tatimi fitimi për t'u paguar	420,485	697,055	-276,571	-39.7%
Detyrime të tjera	3,500,345	4,320,091	-819,746	-19.0%
Kapitali aksionar	35,880,131	34,137,299	1,742,832	5.1%
Kapitali i paguar	14,178,593	14,178,593	-	0.0%
Rezerva	4,733,935	4,779,149	-45,213	-0.9%
Diferenca rivlerësimi	-3,896,687	-3,716,767	-179,920	4.8%
Fitimet e pashpërndara	16,713,167	11,325,424	5,387,743	47.6%
Fitimi i vitit ushtrimor	4,151,124	7,570,901	-3,419,777	-45.2%
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	299,535,840	306,358,374	-6,822,534	-2.2%

Zërat jashtë bilancit mijë Lekë	30/06 2024	31/12 2023	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Angazhime dhe garanci të dhëna	33,967,278	30,982,899	2,984,379	9.6%
Angazhime garanci të marra	737,572	714,809	22,762	3.2%
Transaksione në valutë	7,849,706	5,229,589	2,620,116	50.1%
Angazhime të tjera	-	-	-	-

Shënim: Shifrat janë të pa audituara nga auditorët e jashtëm

	30/06 2024	31/03 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	39,964,810	44,484,726	-4,519,917	-10.2%
	24,467,216	24,686,309	-219,093	-0.9%
	32,074,443	33,951,221	-1,876,778	-5.5%
	116,389,036	114,272,147	2,116,889	1.9%
	78,879,528	72,790,770	6,088,757	8.4%
	329,205	329,205	-	0.0%
	-	-	-	0%
	-	-	-	0%
	2,114,233	2,122,845	-8,612	-0.4%
	3,211,944	3,242,629	-30,686	-0.9%
	2,105,426	2,135,749	-30,322	-1.4%
	299,535,840	298,015,602	1,520,238	0.5%

	30/06 2024	31/03 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	-	-	-	0.0%
	2,730,055	-	2,730,055	-
	8,929,113	5,944,702	2,984,411	50.2%
	242,255,917	243,617,411	-1,361,494	-0.01
	335,241	339,350	-4,109	-0.01
	2,103,305	3,305,645	-1,202,339	-36.4%
	1,347,005	1,327,645	19,360	1.5%
	2,034,242	2,085,691	-51,449	-2%
	420,485	326,491	93,993	0.29
	3,500,345	5,048,597	-1,548,253	-30.7%
	35,880,131	36,020,070	-139,938	-0.4%
	14,178,593	14,178,593	0	0.0%
	4,733,935	4,756,542	-22,607	-0.5%
	-3,896,687	-3,767,669	-129,018	3.4%
	16,713,167	18,896,325	-2,183,158	-11.6%
	4,151,124	1,956,279	2,194,845	112.2%
	299,535,840	298,015,602	1,520,238	0.5%

	30/06 2024	31/03 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	33,967,278	33,613,813	353,465	1.1%
	737,572	743,837	-6,266	-0.8%
	7,849,706	6,141,735	1,707,971	27.8%
	-	-	-	-

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

në mijë Lekë	1/1-30/06 2024	1/1-31/12 2023	Ndryshimi vit me vit absolut	Ndryshimi vit me vit ne %	Tremujori-2 2024	Tremujori-1 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Të ardhura nga interesat	4,806,194	9,101,165	-4,294,971	-47.2%	2,415,934	2,390,260	25,674	1.1%
Shpenzime për interesa	-363,078	-255,111	-107,967	42.3%	-180,389	-182,689	2,301	-1.3%
Te Ardhurat Neto nga Interesat	4,443,116	8,846,054	-4,402,938	-49.8%	2,235,545	2,207,570	27,975	1.3%
Të ardhura nga operacionet financiare	2,116,217	3,581,641	-1,465,424	-40.9%	1,116,332	999,885	116,448	11.6%
Humbje nga operacionet financiare	-137,465	-324,890	187,425	-57.7%	-67,759	-69,706	1,946	-2.8%
Fitimi neto nga veprimet financiare	1,978,752	3,256,751	-1,277,999	-39.2%	1,048,573	930,179	118,394	12.7%
Te ardhurat nga komisionet	2,150,298	4,200,515	-2,050,217	-48.8%	1,116,552	1,033,746	82,806	8.0%
Shpenzime per komisionet	-923,838	-1,992,022	1,068,184	-53.6%	-469,703	-454,135	-15,568	3.4%
Fitimi Neto nga Komisionet	1,226,460	2,208,493	-982,033	-44.5%	646,849	579,611	67,237	11.6%
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	621,020	1,123,155	-502,135	-44.7%	380,711	240,309	140,403	58.4%
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	934	4,619	-3,685	-79.8%	238	696	-458	-65.8%
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtaritë e tjera bankare	-356,566	-404,269	47,703	-11.8%	-282,293	-74,273	-208,020	280.1%
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare	7,913,716	15,034,803	-7,121,087	-47.4%	4,029,624	3,884,092	145,532	3.7%
Shpenzime për personelin	-1,490,793	-2,808,639	1,317,846	-46.9%	-770,559	-720,234	-50,324	7.0%
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	-39,268	-43,298	4,030	-9.3%	-27,996	-11,272	-16,724	148.4%
Shpenzime të përgjithshme administrative	-1,495,332	-2,770,331	1,274,999	-46.0%	-651,354	-843,978	192,624	-22.8%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	-3,025,393	-5,622,268	2,596,875	-46.2%	-1,449,909	-1,575,484	125,575	-8.0%
Te ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për amortizime dhe për fonde rezervë	4,888,323	9,412,535	-4,524,213	-48.1%	2,579,715	2,308,608	271,108	11.7%
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	-339,304	-619,544	280,240	-45.2%	-171,758	-167,547	-4,211	2.5%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fondet rezervë statistikore	36,690	20,469	16,221	79.2%	-11,291	47,981	-59,272	-
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	5,185	393,082	-387,897	-98.7%	-76,337	81,522	-157,859	-
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	-43,273	-526,457	483,184	-91.8%	-29,014	-14,260	-14,754	103.5%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde të tjera rezervë	175,622	-92,211	267,833	-	176,691	-1,069	177,761	-
Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	165,569	170,175	-4,605	-2.7%	75,399	90,171	-14,772	-16.4%
Fitimi (Humbja) para tatimit	4,888,812	8,758,050	-3,869,238	-44.2%	2,543,406	2,345,406	197,999	8.4%
Tatimi mbi fitimin	-737,688	-1,187,149	449,461	-37.9%	-348,561	-389,127	40,566	-10.4%
Fitimi / (Humbja) neto per periudhen	4,151,124	7,570,901	-3,419,777	-45.2%	2,194,845	1,956,279	238,566	12.2%

Shënim: Shifrat janë të pa audituara nga auditorët e jashtëm

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivlerësimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Kapitali më: 01/01/2024	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,508,311	-3,716,767	11,325,424	7,570,901	34,137,299
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	7,570,901	-7,570,901	0
Kalim ne rezerve ligjore	0	0	0	0	0	0	0	0
Diference Rivlerësimi Kapitali	0	0	0	0	-179,920	0	0	-179,920
Rezerve rivlerësimi per ndertesat	0	0	0	-45,213	0	0	0	-45,213
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	-2,183,158	0	-2,183,158
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	4,151,124	4,151,124
Kapitali më: 30/06/2024	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,463,097	-3,896,687	16,713,167	4,151,124	35,880,131

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivlerësimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Kapitali më: 01/01/2023	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,598,738	-2,710,149	11,976,090	4,379,229	32,693,337
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	4,379,229	-4,379,229	0
Kalim ne rezerve ligjore	0	0	0	0	0	0	0	0
Diference Rivlerësimi Kapitali	0	0	0	0	-782,099	0	0	-782,099
Rezerve rivlerësimi per ndertesat	0	0	0	-45,213	0	0	0	-45,213
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	0	0	0
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	3,432,368	3,432,368
Kapitali më: 30/06/2023	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,553,524	-3,492,248	16,355,319	3,432,368	35,298,393

Pasqyra e rrjedhjes së parashë

në mijë Lekë	1/1-30/06 2024	1/1-30/06 2023
Flukset monetare nga aktiviteti operacional		
1. Fitimi (Humbja) i vitit ushtrimor	4,151,124	3,432,368
2. Zera Jo-Monetar ne pasqyren e rrjedhjes se parase		
Zhvleresimi / amortizimi	384,518	341,218
Mjeteve te qendrueshme nxjerre jashte bilanci	0	2,060
Shpenzimet për fondet rezervë	1,651,829	1,619,586
(Transferime nga fondet rezerve)	(1,914,540)	(1,822,782)
(Rritje)/Paksim ne interesat per t'u arketuar	(263,996)	(225,117)
Rritje/(Paksim) ne interesat per t'u paguar	49,266	16,842
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë	(150,577)	(277,564)
Diferenca e rivlerësimit	(179,920)	(782,099)
3. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (1+2)	3,727,704	2,304,513
4. Ndryshime ne kapitalin qarkullues		
(Rritje)/Renie ne Bonot e thesarit dhe bonot e tjera te pershtatshme per rifinancim me BSH	2,729,080	1,782,795
(Rritje)/Renie e te drejtave (aktive) ndaj institucioneve financiare	462,335	2,243,972
(Rritje)/Renie ne hua dhe paradhanie per klientet	2,786,609	2,062,590
(Rritje)/Renie ne letrat me vlere te tregtueshme dhe te vendosjes	(248,759)	244
(Rritje)/ Renie ne mjetet e tjera	574,752	388,091
Rritje/(Renie) ne detyrime ndaj institucioneve financiare	-474,089	5,225,828
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj klienteve	(9,580,624)	(4,478,500)
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj Qeverise dhe Administrates Publike	(18,804)	(20,291)
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj te treteve	-67,407	(45,909)
Rritje/(Renie) ne detyrimet e tjera	(754,694)	(115,154)
5. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (3+4)	-863,898	9,348,180
6. Pagimi i tatimit mbi te ardhurat	(485,341)	(254,100)
Fluksi monetar neto i përdorur në aktivitetin operacional (5+6)	-1,349,239	9,094,079
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Shitje/(Blerja) e interesave pjesemarrëse dhe filialeve	-	-
Shitje/(blerje) e letrave me vlere te investimit	1,830,507	(8,119,553)
Dividentët e marrë	64,080.00	58,245
(Blerja) e mjeteve te qendrueshme	(202,887)	(265,280)
Shitje e mjeteve te qendrueshme	0	2,060
7. Rrjedhja e parase nga veprimtarite e investimit	1,691,700	-8,324,527
Flukset monetare nga aktiviteti financues		
Dividend i paguar nga fitimi	(2,183,158)	-
Rritje/(Renie) ne borxhin e varur	- 71,400	-
Rritje (Paksim) i kapitalit te paguar	- 0	(0)
8. Rrjedhja e parase nga veprimtarite e financimit	(2,254,558)	0
9. (Pakesim)/ Rritje e parase (5+6+7+8)	-1,912,097	769,552
10. Arka dhe Banka Qendrore ne fillim te periudhes	41,876,906	37,893,341
11. Arka dhe Banka Qendrore ne fund te periudhes (10+9)	39,964,810	38,662,893

Klasifikimi i portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike dhënë rezidentëve

30/6/2024

në mijë lekë	Tiranë	Durrës	Elbasan	Shkodër	Korçë	Vlorë	Lushnjë	Gjirokastrë	Fier	Berat	Pogradec	Sarandë	Peshkopi	Kukës	Lezhë	Burrel	Kavajë	Përmet
